



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 63.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 8.1 e) të Rregullës nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.05.2019, merr këtë:

### V E N D I M

Mbi çregjistrimin e Partisë Politike

- I. Për mosdorëzim të të dhënave të ndryshuara vjetore, çregjistrohet nga regjistri i partive politike, Partia Politike, "**Partia e Ballit**" me akronimin PB.
- II. Partia Politike, "Partia e Balli" me akronimin PB, nuk i ka përmbushur obligimet në afatin e shtuar prej njëzet (20) ditësh nga dita e pezullimit, që dalin nga neni 11 i Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- III. Kryetari dhe organet drejtuese të partisë politike "Partia e Balli" me akronimin PB edhe pas marrjes së vendimit për çregjistrim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vazhdojnë të jenë përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe obligimet e krijuara gjatë periudhës së të qënurit aktiv.
- IV. Obligohet Zyra që ta fshij nga Regjistri i Partive Politike, Partinë "Partia e Ballit"
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

### Arsyetim

Partia Politike, "Partia e Ballit" me akronimin PB, e njoftuar për afatin ligjor shtese nuk ka dorëzuar azhurnimet vjetore as edhe në afatin shtesë të dhënat konform nenit 11 të Rregullës nr. 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike. Pas rekomandimit të Zyrës, kjo parti politike është pezulluar me Vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datë 02.03.2018, në pajtim me nenin 6.1 c) dhe i është dhënë afat shtesë sipas nenit 6.1 cc) të Rregullës nr.01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

**Këshilla juridike:** Kryetari i Partisë Politike, "Partia e Ballit" me akronimin PB, z. Ahmet Mulliqi, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, brenda 24 orëve nga marrja e Vendimit .

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

